



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

**AD/GJTHPR/31/24**

**AUTORITETI KOMPETENT I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË** - Kryetarja e Gjykatës Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga av. A.P, ndaj gjyqtarit F.M, bazuar në dispozitën e nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, me datë 20.12.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** ankesa disiplinore e ushtruar nga av. A.P ndaj gjyqtarit F.M, për shkak të **tërheqjes së ankesës nga ana e parashtruesit të ankesës.**

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës av. A.P me datë 03.12.2024 ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit F.M, me pretendimet për shkelje disiplinore gjatë trajtimit të lëndës C.nr.2767/22.

Me datë 12.12.2024, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pranuar parashtresën për tërheqjen e ankesës ndaj gjyqtarit F.M, të dorëzuar nga parashtruesi av. A.P.

Në referim të nenit 9 par. 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh se ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit mund të parashtrojnë personat fizik dhe personat juridik lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore, me tërheqjen e ankesës konsiderohet se nuk ka më një iniciues të kërkesës dhe si e tillë ka vendosur që kërkesa të hudhet për shkak të tërheqjes së ankesës.

Po ashtu, Kryetarja e Gjykatës ka shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga parashtruesi i ankesës nëse të njëjtat përbëjnë bazë për inicim të procedurës disiplinore sipas detyrës zyrtare, ashtu siç parashihet me nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, por që në pretendimet e ngritura nuk ka gjetur shkelje disiplinore të parapara me nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-057.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/31/24, me datë 20.12.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë